

Deklaratë e Unionit të Gazetarëve Qarku Korçë

Ka ardhur koha që Qeveria të kthejë sytë nga gazetarët

Unioni i Gazetarëve të Qarkut të Korçës, pasi u njoh me gjendjen e rënduar shëndetësore dhe ekonomike të gazetarit Zamir Dule , iu bën thirrje organizmave shtetërore, veçanërisht Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që të ndërmarrin hapat e duhura për kurimin e gazetrit Zamir Dule. Këto hapa duhen ndërmarrë me shpejtësi, për të mos rrezikuar humbjen përfundimtare të shikimit të zotit Dule.

Zamir Dule është një ikonë e gazetarisë së kronikës. Ai mund të quhet me plot të drejtë një prej themeluesve të “Kronikës së zezë” në gazetarinë e pas vitit 1990. Në faqet e gazetës “Koha jonë”, Zamir Dule pasqyroi me përkushtim dhe profesionalizëm një gazetari të panjohur më parë në faqet e shtypit shqiptar. Zamir Dule, për këtë shkak u bë pre e ekstremizmave politikë të vitit 1997, duke u rrëmbyer dhe torturuar, gjë e cila la pasoja të pariparueshme në shëndetin e tij.

Pensioni minimal i tij dhe i prinderve të tij e ka zhytur në varfëri ekstreme atë dhe familjen e tij. I bëjmë thirrje zotit Erion Veliaj, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë së Shqipërisë, që të rishohë pagesën që merr zoti Dule, duke bërë të mundur shtimin e kësaj page në një masë që ai të mund të kalojë një jetë të qetë dhe normale, nga ana ekonomike.

Nisur nga ky rast i bëjmë thirrje Qeverisë Shqiptare, që të kthejë sytë nga gazetarët në përgjithësi. Gazetarët sidomos ata lokalë, punojnë në kushte të vështira, me paga të ulëta, në një pjesë të madhe të tyre pa pagesën e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore.

Gazetarët nuk janë fare të mbrojtur nga shkarkimet e pamotivuara prej pronarëve të mediave ku punojnë.

Qeveria duhet të ulet dhe të hartojë ligje dhe mandej t’i zbatojë ato, për të bërë të mundur që edhe gazetarët, këta luftëtarë të informimit dhe fjalës së lirë, të jenë të qetë dhe të pakërcënuar në punën e tyre fisnike.

Për Unionin e Gazetarëve Qarku Koçë
Kryetari Erget Cenolli